



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE

Titulli i Modullit : Soft Skills

Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Frëngjisht

Kohëzgjatja e programit të modullit: 40 orë

Nr. i krediteve: 4 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Nëpërmjet një metodologjie të përzier që përfshin një kuadër teorik, ushtrime praktike, diskutime të hapura dhe simulime.

PËRMBLEDHJE E MODULIT:

Ky modul është hartuar për të përmirësuar aftësitë ndërpersonale dhe profesionale (*soft skills*) të pjesëmarrësve me qëllim që të ndihmojë në realizimin e objektivave të organizatës. Krijimi i një moduli trajnimi për aftësim me aftësi jo teknike (*soft skills*) është shumë i rëndësishëm sepse janë aftësi dhe cilësi të cilat nuk janë teknikisht të drejtpërdrejta, por që janë të domosdoshme për arritjen me sukses të objektivave dhe synimeve në organizatë.

Ky modul trajnimi afatshkurtër që synon kuptimin e konceptit dhe rëndësinë e *soft skills* në fushën profesionale nëpërmjet zhvillimit të komunikimit, ka si qëllim përmirësimin e aftësive për një komunikim të qartë, bindës, me efektivitet, duke përfshirë dëgjimin aktiv. Ky modul synon të zhvillojë aftësitë për të identifikuar prioritetet, për të planifikuar dhe menaxhuar kohën me efikasitet. Gjithashtu përfshin të kuptuarit e karakteristikave të një lideri të suksesshëm dhe zhvillimin e aftësive për të udhëhequr dhe motivuar ekipin drejt arritjes së objektivave të vendosura.

Ky modul ka për qëllim të zhvillojë aftësitë për të punuar efektivisht në ekip, duke përfshirë aftësinë bashkëpunuese për të ndarë informacion, për të marrë përgjegjësi dhe për të kontribuar në projekte të përbashkëta. Synon të zhvillojë aftësitë për të identifikuar, menaxhuar dhe zgjidhur konfliktet në mënyrë konstruktive duke favorizuar bashkëpunimin. Ky modul përfshin të kuptuarit e pikave të forta dhe të dobëta në planin personal për të zhvilluar vetëdijen

personale dhe profesionale e cila ndikon në suksesin në punë.

Përmes këtyre objektivave, trajnimi për *soft skills* synon të ofrojë njohuri dhe aftësi për të përmirësuar aftësitë personale dhe profesionale. Trajnimi përfshin leksione teorike, ushtrime praktike, dhe diskutime të hapura që do t'i pajisin pjesëmarrësit me aftësitë e nevojshme për të përmirësuar komunikimin, punën në grup, menaxhimin e kohës, drejtimin (leadershipin) dhe menaxhimin e konflikteve në mjedisin e punës.

REZULTATET E TË NXËNIT:

1. Komunikimi efektiv:

- Të kuptojnë parimet e komunikimit efektiv.
- Të përdorin teknikat e dëgjimit aktiv.
- Të interpretojnë dhe të përdorin në mënyrë të përshtatshme gjuhën verbale dhe joverbale.

2. Puna në grup:

- Të punojnë në mënyrë efektive brenda një ekipi.
- Të njohin rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme brenda një grupi.
- Të kontribuojnë në ndërtimin e ekipeve të suksesshme.

3. Menaxhimi i kohës:

- Të përdorin teknika efektive të menaxhimit të kohës.
- Të planifikojnë detyrat e tyre në mënyrë efikase.
- Të përdorin mjete të ndryshme për menaxhimin e kohës.

4. Drejtimi dhe motivimi:

- Të kuptojnë konceptet bazë të lidershit dhe stilet e ndryshme të tij.
- Të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të qenë një lider efektiv.
- Të përdorin strategji për motivimin dhe inspirimin e ekipit.

5. Menaxhimi i konflikteve:

- Të identifikojnë dhe të menaxhojnë konfliktet në vendin e punës.
- Të përdorin teknika të negocimit dhe zgjidhjes së problemeve.
- Të zgjidhin konflikte në mënyrë konstruktive dhe të ruajnë një mjedis pozitiv në punë.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

- Përmirësimi i aftësive ndërpersonale dhe profesionale (*soft skills*)
- Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të rëndësishme që do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit në trajnim të kontribuojnë më mirë në arritjen e objektivave të organizatës.
- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit efektiv me qëllim arritjen e objektivave strategjike të organizatës.